



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 198
Datë: 7 / 2 / 2025

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 20 dhe në zbatim të nenit 106, 107 dhe 108 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

**mbi kohëzgjatjen e afatit për përfundimin e studimeve për studentët e nivelit të studimeve
baçelor, master dhe doktoratë**

- I.** Studentët e nivelit bachelor dhe master të cilëve u është vazhduar afati i përfundimit të studimeve sipas Vendimit me nr. prot. 2/764 të datës 23.09.2024, e të cilët në vitin akademik 2025/2026 nuk regjistrojnë vitin e fundit të studimeve sipas programeve të akredituara, nuk do të kenë të drejtë vazhdimi të studimeve përtej afateve statutare.
Ndërsa, studentët që regjistrojnë vitin e fundit të studimeve do të kenë të drejtën për të përfunduar studimet deri më 14 shtator 2026.
- II.** Pas afatit të paraparë në si pikën I të këtij vendimi, e drejta e studimit do iu merret studentëve që nuk i kanë përfunduar obligimet e programit studimor dhe që nuk janë në harmoni me dispozitat statutare dhe të këtij vendimi.
- III.** Studentët e nivelit bachelor dhe master, të cilët kanë kaluar dyfishin e studimeve e të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet, do të kenë të drejtën për ta mbrojtur temën e diplomës përfundimisht deri më 15 shkurt 2026.
- IV.** Për studimet e nivelit të doktoratës, studentët e regjistruar në vitin akademik 2024/2025 e tutje do të jenë subjekt i rregullave të zbatimit të dyfishit të kohëzgjatjes së studimeve dhe dispozitave tjera statutare lidhur me mundësinë e afatit shtesë për realizim të hulumtimit apo disertacionit.
- V.** Studentët e doktoratës të regjistruar para vitit akademik 2024/2025, të cilët kanë tejkaluar limitin e dyfishit të kohëzgjatjes së studimeve sipas dispozitave statutare dhe sipas vendimit të senatit me nr. prot. 2/764 të datës 23.09.2024, apo e kalojnë atë limit në ndërkohë, kanë të drejtë të përfundojnë studimet deri më 30 dhjetor 2027.

- VI.** Studentët e doktoratës të regjistruar para vitit akademik 2024/2025, të cilët nuk e kanë tejkaluar limitin e dyfishit të kohëzgjatjes së studimeve, do të trajtohen sipas afatit 30 dhjetor 2027 si në pikën V të këtij vendimi, apo sipas kufizimit të dyfishit të kohëzgjatjes së studimit, cilado që është më e favorshme për studentin.
- VII.** Të gjithë studentët e doktoratës kanë të drejtë sipas nenit 84 pika 2 e Statutit që të kërkojnë nga këshilli i njësisë akademike që t'i vazhdohet periudha e disertacionit apo e kërkimeve edhe për një (1) vit shtesë sipas një arsytimi të argumentuar. Pas tejkallimit të këtyre afateve në këtë nen, studentëve iu merret e drejta e vazhdimit të studimeve.
- VIII.** Koha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt dhe vazhdimi i kohëzgjatjes së studimeve nga Këshilli i Fakultetit, sipas nenit 107 të Statutit, nuk llogariten në afatet e përcaktuara në këtë vendim. Gjithashtu, në rastet kur afati i studimeve zgjatet nga dekani, sipas nenit 108.2 të Statutit, ky afat shtesë nuk llogaritet brenda kufizimeve të kohëzgjatjes së dyfishit të studimeve sipas dispozitave statutare dhe këtij vendimi. Këto rregulla do të vlejnjë për të gjitha rastet, përfshirë ato të ardhshme.
- IX.** Statusi i studentit të rregullt mbahet brenda dy vjetëve pasi të jenë përfunduar të gjitha provimet. Gjatë kësaj kohe studenti duhet të përfundoj provimin e diplomës që t'i përfundojë me sukses studimet.
- X.** Studentët e të gjitha programeve që vendosin të regjistrohen përsëri në studime nga fillimi mund të kalojnë nëpër procesin e konkursit dhe pastaj në procesin standard të njohjes së lëndëve dhe kredive.
- XI.** Njësitë akademike janë të obliguara të njoftojnë studentët ekzistues dhe ata të regjistruar rishtas mbi dispozitat e këtij vendimi, si dhe të publikojnë vendimin në tabelat e shpalljeve dhe ueb-faqet e fakulteteve.
- XII.** Ky vendim do të vlejë nga viti akademik 2025/2026 e tutje dhe nuk do të lejohet kohë shtesë, respektivisht vazhdim i kohëzgjatjes së afatit për përfundimin e studimeve në kuptim të dispozitave të këtij vendimi.
- XIII.** Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi janë menaxhmenti qendror i UP-së, njësitë përkatëse akademike dhe sekretari i përgjithshëm i UP-së.
- XIV.** Dispozitat e Vendimit me nr. prot. 2/764 i datës 23.09.2024, do të vlejnjë përfundimisht vetëm deri në përfundimin e vitit akademik 2024/2025.
- XV.** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit në Senat, 29.01.2025.

Arsyetim

Senati i Universitetit të Prishtinës synon që me këtë vendim të ofroj një bazë shtesë të qartë dhe të rregullt për interpretimin e afateve të vazhdimit të studimeve përtej dyfishit të kohës së përcaktuar nga dispozitat statutare. Vendimi synon të sigurojë që periudhat e pauzimit të statusit të studentit dhe zgjatjet e miratuara nga organet përkatëse të universitetit të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të harmonizuar me kufizimet statutare, duke shmangur keqinterpretimet dhe tejkasimet e pajustificuara të kohëzgjatjes së studimeve. Për më tepër, ky vendim kontribuon në konsolidimin e një politike të ekuilibruar, e cila adreson me ndjeshmëri rrethanat specifike të studentëve, ndërsa garanton ruajtjen e standardeve akademike dhe promovon efikasitetin në menaxhimin e burimeve universitare.

Duke u mbështetur në atë çfarë u tha më lart, Senati i UP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryestres i Senatit të UP-së

Arben Hajrullahu
Prof. Arben Hajrullahu, Rektor

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Senatit të UP-së;
3. Njësive Akademike të UP-së;
4. Parlamentit të Studentëve;
5. Zyrës ligjore.